



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 9 Datë 05. 09. 2017

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ EUROBIZNES ” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 7055/4, datë 24.12.2015 dhe miratimin përfundimtar Nr.3613/6, datë 10.05.2017 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujqor të subjektit “**EUROBIZNES**” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin- Bunë,

V e n d o s i :

1-Miratimin e lejes së subjektit “**EUROBIZNES sh.p.k.**” me administratore Znj.Anthulla BOÇI, për përdorim të burimit ujqor **Përroi i Mullirit** për prodhim energjie elektrike në Lusën, Njësia Adm. Ujmisht,Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC LUSNA 3** do të ketë këto të dhëna:

Për ndërtimin e H/C Lusna 3 nuk do të ketë vepër marrje në Përroin e Mullirit pasi do të shfrytëzohet uji i shkarkuar nga godina e H/C Lusna 2.

Koordinatat e shkarkimit të H/C Lusna 2 : X – 44 49 384; Y –46 43 126; Z - +810 m;

Koordinatat e godinës së centrali: X – 44 48 523; Y –46 42 976; Z - +440m;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : X – 44 48 523; Y –46 42 976; Z - +440m;

Prurja mesatare vjetore e burimit : Q mes= 0.084 m³/sek;

Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 0,25m³/sek;

Prurja ekologjike: Qekol= 0.017 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q= 0.25 m³/sek.

2-Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Martin PLLUMBI

Kryetar

Paulin RADOVANI

